34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-25-6512-5-2-1/C1839

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 120 ditësh
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 90 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit në baza ditore! Libri ndërtimor dhe Ditari ndërtimor do të mbahen në vendndërtim gjatë tërë kohës së ekzekutimit të punimeve nga fillimi deri në përfundimin e punimeve dhe deri në lëshimin e Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm të Punëve (dhe të lëshohet Certifikata e Përdorimit). Udhëheqësi i vendndërtimit duhet të jetë prezent në vendndërtim me orarë të plotë të punës nga dita e parë e fillimit të punëve deri në përfundimin e tyre gjatë tërë kohës së implementimit të kontratës për organizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve në vendndërtim, konform dokumentacionit ndërtimor dhe rregulloreve dhe standardeve teknike të ndërtimit. Inxhinierët përgjegjës i fazës së ndërtimit duhet të jenë prezent në vendndërtim me orarë të plotë gjatë tërë kohës sa ekzekutohen punime nga fusha përkatëse e tyre inxhinierike për të kontrolluar,verifikuar,sasinë dhe cilësinë e materialeve dhe punimeve dhe për të verifikuar zbatimin e normave dhe standardeve të ndërtimit për fazën e tij.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Kontratës është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>N/A</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% e vlerës së kontratës. Kjo shumë do të ndalet nga çdo pagesë (situation i punëve) e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë" të OE-së. Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve 10%
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA						
PROJEKTI KRYESOR I RRUGËS "KOSTURI" SIPAS PLANT RREGULLUES NË ARBERI						
Aksi 1 me L=326,62m,						
Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1.0 PUNËT E DEMOLIMIT						
1	1.1	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike per rrugë, trotuare dhe të gjitha objektet ndimëse.	m'	326.62	1.00 €	326.62 €
	1.2	Krijimi i hapsirave per qarkullim të pa ndërprer të këmbësorve dhe automjeteve gjatë kohes së zhvillimit të punimeve.	m'	326.62	1.00 €	326.62 €
	1.3	Prejra vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m'	12.00	10.00 €	120.00 €
	1.4	Demolime dhe transporti deri ne deponi I pllakave nga betoni.	m ²	50.00	10.00 €	500.00 €
	1.5	Demolime dhe transporti deri ne deponi I gurëve skajor nga betoni.	m'	50.00	5.00 €	250.00 €
	1.6	Demolime dhe transporti deri ne deponi I rrethojave dhe parapedit nga betoni.	m'	60.00	5.00 €	300.00 €
	1.7	Këputimi i rrafshmeve egzistuese nentokore ne rast demolimi gjatë punimeve në rrugë	m'	326.62	3.00 €	979.86 €
	1.8	Demolime dhe transporti deri ne deponi I materialeve të betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m ³	15.00	20.00 €	300.00 €
	1.9	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	orë	5.00	15.00 €	75.00 €
TOTAL PUNËT E DEMOLIMIT :						3,178.10 €

Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2.0 PUNËT E DHEUT					
2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km.	m ³	3,416.61	1.00 €	3,416.61 €
2.2	Grryerja, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmerisë 30N/mm ²	m ²	3,592.82	1.00 €	3,592.82 €
2.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m ²	m ²	3,592.82	1.20 €	4,311.38 €

2

2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20%, shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulin e ngjeshmërisë 50MN/m ²	m ³	1,400.93	9.00 €	12,608.37 €
2.5	Furnizimi, transporti, punimi i bankinave me tampon.	m ³	33.00	7.00 €	231.00 €
PUNIMET E DHEUT					
					24,160.18 €

Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
3.0 PUNËT E TAMPONIT					
3.1	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt si shtresë rrafshuese nën kocka betoni me t=5cm (në gjendje të ngjeshur).	m ³	57.11	10.00 €	571.10 €
3.2	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt me t=5cm (si shtresë mbrojtëse e gjeotekstilit në gjendje të ngjeshur).	m ³	179.64	10.00 €	1,796.40 €
3.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>80MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-63mm me trashësi 40cm në trup të rruges (në gjendje të ngjeshur) si bazë për vendosjen e trupit të rruges.	m ³	1,243.22	12.00 €	14,918.64 €
3.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>100MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-31.5mm me trashësi t=15 cm në rrugë (në gjendje të ngjeshur) si bazë për vendosjen e asfaltit.	m ³	457.82	13.00 €	5,951.66 €
TOTAL PUNËT E TAMPONIT:					23,237.80 €

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
4.0 PUNËT E BETON DHE ASFALTIT						
4.1	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 18/24 MB40 M100 në shtresë betoni MB20 me pamje ngjyrë të bardhë (1 perber nga cementi dhe agregati I bardhë) duke përfshir edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngjirje shkrije.		m'	612.00	12.00 €	7,344.00 €

5

5.2	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë rrethore përfshirë dhe shenjen STOP me diametër 600 mm.	copë	14.00	150.00 €	2,100.00 €
5.3	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e tabelave drejtkëndore të informimit me dimensione 600x600mm	copë	3.00	150.00 €	450.00 €
Verejtje: Foliet e sipërfaqeve retroreflektuese të shenjave të trafikut duhet të punohen se paku të shkallës së dytë retro-reflektuese të tipit High Intensity Grade - HIG.					
TOTALI SINJALIZIMI VERTIKAL					2,550.00 €

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
6	7.0 SINJALIZIMI HORIZONTAL					
	7.1	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave gjatësore të bardha të plota (gjerësia 120 mm)	m'	825.00	2.50 €	2,062.50 €
	7.2	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të ndërprera (1+1 m, me gjerësi 120 mm)	m'	130.00	2.30 €	299.00 €
	7.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha terthore (të plota) të ndalimit (gjerësia 500 mm)	m'	6.00	15.00 €	90.00 €
	7.4	Furnizimi dhe punimi në rrugë për shenjimin e vendkalimit të këmbeve (pjesa e ngjyrosur e rrugës)	m ²	18.00	15.00 €	270.00 €
	7.5	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave terthore të bardha të ndërprera, para vendkalimit të këmbësorëve (0.5+0.5 m, me gjerësi 0.25 m)	m'	3.00	20.00 €	60.00 €
	7.6	Furnizimi dhe punimi në rrugë për vendosjen e shigjetave për orientim të levizjes	m ²	17.50	15.00 €	262.50 €
Verejtje: Shenjat horizontale duhet të punohen nga masat e perziera plastike dy komponenteshe të ftohë me perberje të grimcave fluoroceente						
TOTALI SINJALIZIMI HORIZONTAL						3,044.00 €

PROJEKTI KRYESOR I RRUGËS: "KOSTUR" SIPAS PLANIT RREGULLUES NË ARBËRI		
Aksi 1 me L=326,62m.		
1.0	PUNËT E DEMOLIMIT	3,178.10 €
2.0	PUNËT E DHEUT	24,160.18 €

3.0	PUNËT E TAMPONIT	23,237.80 €
4.0	PUNËT E BETON DHE ASFALTIT	73,355.21 €
5.0	SINJALIZIMI VERTIKAL	2,550.00 €
6.0	SINJALIZIMI HORIZONTAL	3,044.00 €
Totali:		129,525.29 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK						
Rruga "Kosturi" dhe rrugëve lidhëse me rrugën "Ferid Curri" sipas planit rregullues në Arberë						
Vërejtje: Para seciles porosi të materialeve, për secilin material të përshkruar në paramasë, menaxherit të kontratës duhet ti ofrohen për aprovim Punëkryesi duhet të furnizoj dhe montoj një gardh të përkohshëm me material të fortë përreth vendpunishtes për të siguruar një zhvillim të						
Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
		Para fillimit të punimeve duhet të bëhet piketimi gjeodezik në terren i trasesë së projektuar të rrjetit të kanalizimit ATM duke përfshirë: aksin e gypit, pusetat, dhe elemente të tjera të rrjetës me piketa (shenja me ngjyrë permanente në kunjia druri anash kanalit dhe pusetave). Ky piketim duhet të realizohet në form të vazhdueshme paralel me punimet ku perveq piketave të vendosura duhet që pajtë të vendosja e gypave të bëhet me matje(GPS, TCR ose Nivelir).	m'	299.00	1.00 €	299.00 €
1	1.1	Inqizimi, i rrjetit sipas gjendjes së ekzekutuar të kanalizimit (pas ekzekutimit të rrjetit të kanalizimit). Inqizimi gjeodezik duhet të bëhet nga kompania e licensuar për këtë lloj aktiviteti. Materiali duhet ti dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	299.00	1.00 €	299.00 €
	1.2	Pastrimi i terrenit, demolimi i materialeve tjera të ngurta, pustave ekzistuese, gypave të infrastruktures nëntokësore etj., në pjesën ku do të zhvillohet traseja e kanalizimit si dhe largimi i ktyre materialeve deri në deponi (aty ku percakton organi mbikëqyres)	paushall	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
	1.3					

1.4	Realizimi i lidhjes së gypave të kan atn nga parcellat në gypi e projektuar kë kan Atm. Në qmim të perfshihe të gjitha pozicionet e nevojshme per një funksionim të plotë.	copë	6.00	120.00 €	720.00 €
1.5	Gërmimi me dorë , makinë, dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullit dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjanohet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në H= 1.6m' , kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit.				
a	gërmimi me makinë 90%	m³	538.20	2.50 €	1,345.50 €
b	gërmimi me dorë 10%	m³	59.80	3.00 €	179.40 €
1.6	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit.	m'	299.00	2.00 €	598.00 €
1.7	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 30 puseta	m³	31.20	5.00 €	156.00 €
1.8	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m²	299.00	1.00 €	299.00 €
1.9	Furnizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt.	m³	119.00	13.00 €	1,547.00 €
1.10	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	299.00	0.20 €	59.80 €
1.11	Matja gjeodezike e elementeve të rrjetit si dhe matja e gypit para mbulimit të kanalit në çdo lidhje mes dy gypave dhe ne mes te gypit, të dhenat e matjeve duhet te pergaditen ne formatin DWG dhe EXCEL dhe te dorezohen në raporte javore tek KRUP-DPZH.	m'	299.00	1.50 €	448.50 €
1.12	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/ m2.	m³	463.45	12.00 €	5,561.40 €

1.13	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	5.00	20.00 €	100.00 €
TOTAL PUNËT E DHEUT :					
					12,612.60 €

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2		2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME				
	2.1	Furnizimi transporti montimi i pllakave me C-25/30 të parafabrikuar me dimensione të kornizes 120x120x20cm .				
	a	për puseta rrugore	copë	12.00	100.00 €	1,200.00 €
	2.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për puseten e ujmbledhësave me dim: 60*40*100cm.	copë	13.00	100.00 €	1,300.00 €
	2.3	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusëtë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusetës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
	a	Unaza në formë të konit	copë	12.00	65.00 €	780.00 €
	b	Me profil konstant	m'	20.00	50.00 €	1,000.00 €
					TOTALI	4,280.00 €

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		3,0 PUNËT METAL PUNUESE DHE PE				

3		Furnizimi transporti montimi i kapakëve prej gize DN-600 mm, konform Standardit EN124, klasa D400 kN. pesha e kapakut T=40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej beton-armesë C-25/30 të parafabrikuar me dimensione të kornizes 120x120x20cm .				
	3.1	për puseta rrugore	copë	12.00	150.00 €	1,800.00 €
	a	Shkallët në puseta				
		Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusetës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logarifja me copë.				
	3.2	për puseta rrugore	copë	36.00	3.00 €	108.00 €
4	3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësat (prej gize), për pesha të rënda. Në çmim të llogarohet: betonimi i kurorës prej beton armesë C-25/30.	copë	13.00	150.00 €	1,950.00 €
					TOTALI	3,858.00 €
		4,0 PUNËT E MONTUESE				
		Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar të kanalizimit PE SN8, në bazë të standardit EN 13476-3 dhe ISO 9969, duke përfshirë edhe lidhjen e gypave me puseten e kanalizimit, duke mbyllur zbrazdësitat me llaq qimento, në mënyrë që të mos ketë infiltrime të ujrave anësore si dhe ujrave nëntokësore në puseta. Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				
	4.1	(për Um) DN- 200 mm	m'	35.00	6.00 €	210.00 €
	a	DN- 315 mm	m'	225.00	15.00 €	3,375.00 €
	c	DN- 500 mm	m'	74.00	45.00 €	3,330.00 €
	d				TOTALI	6,915.00 €

[illegible]

5.1	Testimi i rrjetit të kanalizimit ATMOSFERIK sipas normave teknike, nga kompanija e certifikuar për këtë lloj aktiviteti, si dhe përpilimi i raportit me shkrim për këtë testim. Raporti i testimit duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	299.00	1.00 €	299.00 €
5.2	Pas përfundimit (implementimit) dhe para pranimit teknik final të projektit, duhet të bëhet kompletimi i dokumentacionit teknik ku duhet të përfshihet i gjithë dokumentacioni duke përfshirë: Situacionin e rrjetit, Profilet gjatësore të zbatuara, detalet e pusetave, nyjet, fotot gjate implementimit dhe inqizimi gjeodezik i trases sipas pershkrimit në specifikacionin teknik (Inxhinierik) dhe të dorëzohen në formë manuale (kopje e fortë) dhe digjitale (DWG dhe SHAPEFILE) në 3 kopje. Kopjet e forta duhet të jenë të përgaditur me përpjesë sipas normave teknike të projektimit.	m'	299.00	1.00 €	299.00 €
				TOTALI	598.00 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK				
Rruga "Kosturi" dhe rrugëve lidhëse me rrugën "Ferid Curri" sipas planit rregullues në Arbëri				
1.0	PUNËT E DHEUT		12,612.60 €	
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME		4,280.00 €	
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE		3,858.00 €	
4.0	PUNËT MONTUESE		6,915.00 €	
5.0	TESTIMI I RRJETIT		598.00 €	
	Totali:		28,263.60 €	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN FEKAL	
Rruga "Kosturi" dhe rrugëve lidhëse me rrugën "Ferid Curri" sipas planit rregullues në Arbëri	
Vërejtje: Para seciles porosi të materialeve, për secilin material të përkthuar në paramasë, menaxherit të kontratës duhet ti ofrohen për aprovim dokumentacionet e nevojshme (si psh. Çertifikatat e kualitetit, katalogjet etj.)	

Punëkryesi duhet të furnizoj dhe montoj një gardh të përkohshëm me material të fortë përreth vendpunishtes për të siguruar një zhvillim të punimeve pa rreziqe për jetën e pjesmarrësve në punime dhe palës së tretë. Punëkryesi në këtë ofertë duhet të përfshijë edhe koston e ndërtimit të rrugëve të përkoshme alternative për qasje në punishte pa shkakto dëmtime në teren dhe të kthej terenin në gjendjen e planifikuar pas përfundimit të punimeve. Punëkryesi gjithashtu duhet bëjë furnizime me ujë , energji elektrike etj pranë autoriteteve lokale përkatëse gjatë fazës së ndërtimit. Vërejtje: Punëkryesi duhet që të posedojë të gjitha instrumentet e nevojshme për detektimin e instalimeve të ndryshme nëntokësore në mënyrë që ti shmangët dëmtimeve të instalimeve nëntokësore ne pozicionet ku zhvillohen punimet. Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Pozicionet ne projekt jane te parallogaritura keshtu qe llogariftja e pozicioneve të bëhet sipas gjendjes së realizuar në teren. Nëse kemi punime në rrugë t'i kërkohet edhe plani i menaxhimit të komunikacionit, si pozicioni i veqnat.

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
	1.1	Para fillimit të punimeve duhet të behet piketimi gjeodezik në terren i trasesë së projektuar të rrjetit te kanalizimit fekal duke perfshirë: aksin e gypit, pusetat, dhe elemente të tjera të rrjetës me piketa (shenja me ngjyrë përmanente ne kunja druri anash kanalit dhe pusetave). Ky piketim duhet të realizohet në form të vazhdueshme paralel me punimet ku perveq piketave te vendosura duhet që pajtjetër vendosja e gypave të bëhet me matje(GPS, TCR ose Nivelir).	m'	305.00	1.00 €	305.00 €
	1.2	Inqizimi, i rrjetit sipas gjendjes së ekzekutuar të kanalizimit (pas ekzekutimit të rrjetit të kanalizimit). Inqizimi gjeodezik duhet të bëhet nga kompanija e licensuar për këtë lloj aktiviteti. Materiali duhet ti dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	305.00	1.00 €	305.00 €

1.3	Pastrimi I terenit, demolimi i materialeve tjera të ngurta, pustave ekzistuese, gypave të infrastruktures nëntokësore etj., në pjesën ku do të zhvillohet traseja e kanalizimit si dhe largimi i ktyre materialeve deri në deponi (aty ku percakton organi mbikëqyrës)	paushall	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
1.4	Realizimi i lidhjeve të gypave të kanalizimit fekal nga parcellat në rrjetin e ri të kanalizimit, duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	6.00	120.00 €	720.00 €
1.5	Gërmimi me dorë, makinë, dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikëqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullit dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjanohet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në H= 3,0m' , kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit.				
a	gërmimi me makinë 90%	m³	713.70	2.50 €	1,784.25 €
b	gërmimi me dorë 10%	m³	79.30	4.00 €	317.20 €
1.6	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit.	m'	305.00	1.00 €	305.00 €
1.7	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 100 cm, në dy metër gjatësi kol. 30 puseta	m³	31.20	5.00 €	156.00 €
1.8	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m²	305.00	1.00 €	305.00 €
1.9	Furrizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit në projekt.	m³	122.25	13.00 €	1,589.25 €
1.10	Furrizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart për rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	305.00	0.20 €	61.00 €

		Matja gjeodezike e elementeve të rrjetit si dhe matja e gypit para mbulimit të kanalit në çdo lidhje mes dy gypave dhe ne mes te gypit, të dhenat e matjeve duhet te pergaditen ne formatin DWG dhe EXCEL dhe te dorezohen në raporte javore tek KRUP-DPZH.	m'	305.00	2.00 €	610.00 €
1.11		Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2.	m³	655.75	13.00 €	8,524.75 €
1.12		Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	5.00	20.00 €	100.00 €
1.13						
TOTAL PUNËT E DHEUT :						
						16,082.45 €

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME				
2.1		Furnizimi transporti montimi i pllakave me C-25/30 të parafabrikuar me dimensione të kornizes 120x120x20cm .	copë	12.00	100.00 €	1,200.00 €
a		për puseta rrugore	copë	12.00	80.00 €	960.00 €
3.2		Ngrija, nivelizimi dhe betonimi i kapakëve për pusetat egzistues me kapakë prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritët edhe betonimi i kurorës prej beton-armesë C-25/30 të parafabrikuar me dimensione të kornizes 120x120x20cm .	copë	6.00	80.00 €	480.00 €
2		Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusetës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
2.2		Unaza në formë të konit	copë	12.00	65.00 €	780.00 €
a						

	b	Me profil konstant	m'	24.00	60.00 €	1,440.00 €
					TOTALI	4,860.00 €

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		3.0 PUNËT METAL PUNUESE				
		Furnizimi transporti montimi i kapakëve prej gize DN-600 mm, konform Standardit EN124, klasa D400 kN. peshë e kapakut T=40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej beton-armesë C-25/30 të parafabrikuar me dimensione të kornizes 120x120x20cm .	copë	12.00	160.00 €	1,920.00 €
3		Shkallët në puseta				
		Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusetës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.				
3.2	a	për puseta rrugore	copë	48.00	3.00 €	144.00 €
					TOTALI	2,064.00 €
		4.0 PUNËT E MONTUESE				
4		Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar të kanalizimit HD PE SN8, në bazë të standardit EN 13476-3 dhe ISO 9969, duke përfshirë edhe lidhjen e gypave me puseten e kanalizimit, duke mbyllur zbrazëdsirat me llaq qimento, në mënyrë që të mos ketë infiltrime të ujrave anësore si dhe ujrave nëntokësore në puseta. Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				
4.1	a	DN-250 mm	m'	225.00	9.00 €	2,025.00 €
	b	për kolektorë DN- 315 mm	m'	80.00	13.50 €	1,080.00 €
					TOTALI	3,105.00 €

	5.0 TESTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT FEKAL		
--	--	--	--

5.1	Testimi i rrjetit të kanalizimit FEK sipas normave teknike, nga kompanija e certifikuar për këtë lloj aktiviteti, si dhe përpilimi i raportit me shkrim për këtë testim. Raporti i testimit duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	305.00	1.00 €	305.00 €
5.2	Pas përfundimit (implementimit) dhe para pranimit teknik final të projektit, duhet të bëhet kompletimi i dokumentacionit teknik ku duhet të përfshihet i gjithë dokumentacioni duke përfshirë: Situacionin e rrjetit, Profilet gjatësore të zbatuara, detalet e pusetave, nyjet, fotot gjate implementimit dhe inqizimi gjeodezik i trases sipas pershkrimit në specifikacionin teknik (Inxhinierik) dhe të dorëzohen në formë manuale (kopje e fortë) dhe digjitale (DWG dhe SHAPEFILE) në 3 kopje. Kopjet e forta duhet të jenë të përgaditur me përpjesë sipas normave teknike të projektimit.	m'	305.00	1.00 €	305.00 €
				TOTALI	610.00 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN FEKAL	
Rruga "Kosturi" dhe rrugëve lidhëse me rrugën "Ferid Curri" sipas planit rregullues në Arbëri	
1.0	PUNËT E DHEUT 16,082.45 €
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME 4,860.00 €
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE 2,064.00 €
4.0	PUNËT MONTUESE 3,105.00 €
5.0	TESTIMI I RRJETIT 610.00 €
	Totali: 26,721.45 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E UJËSJELLËSIT	
Rruga "Kosturi" dhe rrugëve lidhëse me rrugën "Ferid Curri" sipas planit rregullues në Arbëri	
Vërejtje: Para porosisë së materialeve, për secilin material të pershkruar në paramasë, menaxherit të kontratës duhet ti ofrohen për aprovim dokumentacionet e nevojshme (si psh. Çertifikatat e kualitetit, katalogjet etj.)	

